

NJOFTIM PËR MEDIAT

BOSHLLËQE DHE MUNGESË KONSISTENCE NË DEKLARIMIN E PASURISË DHE INTERESAVE TË FUNKSIONARËVE NË RRUGËN DREJT ZBULIMIT TË KORRUPSIONIT

Sot, më 28 maj 2025, Qendra për Komunikime Qytetare, Shoqata e Këshilltarëve Tatimorë dhe Aktivo e publikuan “Hulumtimin për zbulimin e konfliktit të mundshëm të interesave dhe keqpërdorimit të pushtetit gjatë prokurimeve publike nga personalitetet politike”, përmes të cilit rezultoi që:

- Nëpërmjet Regjistrin për Pronarët e Vërtetë, janë zbuluar pronësi në kompani të individëve politikisht të ekspozuar (kryetarë komunash dhe ministra), pronësi të cilat nuk i kanë të paraqitura në deklaratat e interesave që i kanë parashtruar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK).
- Nga 360 funksionarët e mëhershëm dhe aktual, të cilët i kemi analizuar, 41 prej tyre paraqiten si pronarë të vërtetë në ndonjë firmë; 23 funksionarë, nga këta të fundit i kanë fshehur tërësisht ose pjesërisht titujt e tyre në firmat kur kanë parashtruar deklaratë interesi në KSHPK.
- Dallimet në të dhënat për interesat afariste të funksionarëve flasin për një mungesë të kontrollit dhe verifikimit adekuat mbi saktësinë e të dhënave edhe në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë edhe në deklaratat e interesit që personat e zgjedhur dhe të emëruar i parashtrojnë në KSHPK.
- Firma, të cilat janë në pronësi të kryetarëve të komunave dhe të ish-ministrave kanë fituar kontrata për prokurime publike, për koncesione si dhe licenca që u janë lëshuar nga institucione shtetërore.
- Qytetarëve, gazetarëve dhe organizatave qytetare u është pamundësuar që në mënyrë aktive të marrin pjesë në zbulimin e konfliktit potencial të interesave dhe keqpërdorimeve të pushtetit nga ana e bartësve të funksioneve. Regjistri për Pronarët e Vërtetë nuk është i hapur për publikun dhe qasja tek informacionet në të është me pagesë, ndërsa të dhënat për biznes-interesat e funksionarëve në sistemin elektronik të KSHPK-së, që është i aksesshëm për publikun, nuk janë të plota.
- Në deklaratat e interesit të parashtruara në KSHPK, funksionarët paraqesin të dhëna vetëm për anëtarët e familjes më të ngushtë me të cilët jetojnë nën kulmin e njëjtë, ndërsa deklaratat e parashtruara në KSHPK deri në fund të vitit 2023 janë vetëm në format të shtypur dhe nuk gjenden në ueb-portalin e specializuar, etj.
- Në kushte kur për informacionet për pronësi duhet të paguhet, ndërsa deklaratat e interesit në numër të madh të rasteve nuk janë gjithëpërfshirëse dhe të sakta, bëhet e lehtë për pronarët e firmave të fshehen, në vend që publikisht të bëhet lidhja dhe të bëhen publike firmat që kanë fituar tenderë dhe koncesione me gjithë pronarët e tyre.

Për më tepër informacione, ju lutemi ta kontaktoni Qendrën për Komunikime Qytetare në (02) 3213-513 ose në center@ccc.org.mk.

Projekti “Shfrytëzimi i të dhënave të pronarëve të vërtetë me qëllim të reduktimit të korrupsionit” është i përkrahur nga Qeveria e Zvicrës nëpërmjet Civika mobilitas. Mendimet që janë shprehur në këtë botim nuk janë doemos reflektim i qëndrimeve të Qeverisë zvicerane, Civika mobilitas ose të organizatave që e zbatojnë këtë projekt.